



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1074/ 7 prot.

Datë 24.07.2025

**V E N D I M**

**Nr. 950 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 24.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi ri-vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale 319,256,430 (treqind e**

nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk (përfaqësues) me NIPT L46827004L dhe adresë: Shkoder, Shkoder, Rruga Daut Boriçi, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, volumni 36, faqe 14 & “VARAKU E” Shpk me NIPT J61902509S dhe adresë: Rruga Xhafzotaj-Durrës.

**Autoriteti Kontraktor:**

Autoriteti Rrugor Shqiptar me adresë: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

**Persona të interesuar:**

Operatori ekonomik “JUBICA” SHPK me NIPT K26529001I, me adresë: Rruga ‘Luigj Gurakuqi’, Kukle, nr 108, Shkodër

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)”** (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale **319,256,430** (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 02.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK
3. ROZAF 94
4. I.D.K-KONSTRUKSION

II.3. Në datën 20.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i skualifikuar.

|                                                |                |
|------------------------------------------------|----------------|
| 1. JUBICA SHPK                                 | I Kualifikuar  |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | I Skualifikuar |
| 3. ROZAF 94                                    | I Skualifikuar |
| 4. I.D.K-KONSTRUKSION                          | I Skualifikuar |

II.4. Me datë 29.10.2024, në Vendimin nr.1515/2024 datë 29.10.2024 Komisioni vendosi:

*1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

*2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.*

*3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.*

*4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

*5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.*

*6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK*

*7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

*8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.5. Në datën 01.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për rivlerësimin e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i kualifikuar pas zbatimit të vendimit të KPP-së nr.1515/2024 datë 29.10.2024.

|                                                |               |
|------------------------------------------------|---------------|
| 1. JUBICA SHPK                                 | I Kualifikuar |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | I Kualifikuar |

II.6. Në datë 12.11.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar ftesën për tender, për fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit duke iu drejtuar operatorëve ekonomikë të kualifikuar:

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.6.1. Në datë 02.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.6.2. Në datë 13.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë fazë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

- |                                                |               |
|------------------------------------------------|---------------|
| 1. JUBICA SHPK                                 | 296,9994 pikë |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | 297 pikë      |

II.7. Në datë 24.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.8. Në datën 30.12.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 3788/2024, datë 18.12.2024 dhe numër elektronik A/2024/4940, datë 30.12.2024, e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3788/2 prot., datë 31.12.2024 ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi shpalljen fitues në procedurën e shortit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, si dhe kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular ankese”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar ankesa me nr. 3788/3, datë 06.01.2025.

II.11. Më datë 07.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet postës elektronike, protokolluar me nr. 3788/4, datë 07.01.2025.

II.12. Më datë 09.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me nr. 3788/5, datë 09.01.2025.

II.13. Në datën 10.01.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4940, të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike”, të protokolluar me tonën me nr. 3788/6 prot, datë 10.01.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar pjesërisht** ankesën e ankimuesit.

II.14. Me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025, KPP iu drejtuar autoritetit kontraktor ARRSH, nëse BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, ka dorëzuar apo jo “Formular Argumentesh”, pranë autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar? A e keni njoftuar BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Jubica”SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.

II.15. Me shkresën përcjellëse me nr. 189/1 prot., datë 13.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/8 prot., datë 16.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacioni nëpërmjet shërbimit postar.

II.16. Me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për ti kërkuar informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për çdo fazë, procesverbali i hedhjes së shortit, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK, të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.17. Me shkresën përcjellëse me nr. 473/1 prot., datë 27.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/10 prot., datë 29.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025 të KPP-së.

II.18. Me shkresën përcjellëse me nr. 784/1 prot., datë 06.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/11 prot., datë 10.02.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025 të KPP-së.

II.19. Më datën 03.03.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 325/2025, datë 03.03.2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.20. Me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, protokolluar me tonën nr. 3788/17 prot., datë 21.03.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 325/2025, datë 03.03.2025, si vijon: “...Referuar shkresës tuaj nr. 3788/15 prot., datë 03.03.2025 me lëndë “dërgim Vendimi”, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me Nr. REF-10943-06-24-2024, po ju dërgojmë procesverbalin mbi rivlerësimin e propozimit ekonomiko-teknik, nga komisioni i vlerësimit të ofertave”.

-procesverbal nr. 5 datë 21.03.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

II.21. Më datën 02.04.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 431/2025, datë 02.04.2025, ku vendosi:

1. Autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.325/2025, datë 03.03.2025.
2. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës të prokurimit prokurimit, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit: “Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës së subjektit të interesuar të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

II.22. Në datën 25.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 793/2025, datë 25.03.2025 dhe numër elektronik A/2025/5179, datë 25.03.2025, e nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.23. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 793/1 prot., datë 26.03.2025 ku u konstatua se, nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.24. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular i paraqitjes së argumentave”, ardhur nëpërmjet sisemit elektronik, protokolluar me nr. 793/2 prot., datë 02.04.2025.

II.25. Me shkresën me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, ku referuar pikës 4 të nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke i kërkuar informacion lidhur mbi vendimin e marrë mbi trajtimin e ankesës.

II.26. Me shkreën nr. 2846/1 prot., datë 08.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 793/4 prot., datë 10.04.2025, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje shkresës me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025 duke argumentuar se: “.....ju bëjmë me dije se, ankesa nuk është marrë në konsideratë, pasi autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësim të procedurës në përputhje dhe në zbatim të plotë të Vendimit nr. 325/2025 datë 03.03.2025 të KPP-së, duke efaktuar dhe dokumentuar me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, me lëndë “Zbatim vendimi”.

II.27. Më datën 14.04.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 498/2025, datë 14.04.2025, ku vendosi:

*1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote)”, me fond limit 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH ose 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë*



*e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmbëdhjetë) Euro pa TVSH, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit: “Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

2. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
  3. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK.*
  4. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
  5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.27.1. Në datë 17.04.2025 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e Propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë fazë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

|                                                |        |      |
|------------------------------------------------|--------|------|
| 1. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK | 294.00 | pikë |
| 2. OE “JUBICA” SHPK                            | 299.97 | pikë |

II.27.2. Në datë 18.04.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 21, datë 28.04.2025, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Jubica” SHPK.

II.28. Në datën 24.04.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5267, si dhe nr. protokolli 1074/2025 me datë 24.04.2025, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.29. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1074/1 prot., datë 25.04.2025 ku u konstatua se, nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e ri-vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.30. Me shkresën me nr. 1074/2 prot., datë 19.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, ku referuar pikës 4 të nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor

ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke i kërkuar informacion lidhur mbi vendimin e marrë mbi trajtimin e ankesës.

II.31. Me shkresën nr. 4082/1 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1074/3 prot., datë 30.05.2025, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje shkresës me nr. 1074/2 prot., datë 19.05.2025 duke argumentuar se: *“.....ju bëjmë me dije se, ankesa nuk është marrë në konsideratë, pasi ritheksojmë se autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësim të procedurës në përputhje dhe në zbatim të plotë të Vendimit nr. 325/2025 datë 03.03.2025 të KPP-së, duke efaktuar dhe dokumentuar me shkresën nr. 2118/1/1 prot., datë 21.03.2025, me lëndë “Zbatim vendimi”.*

II.32. Me shkresën nr. 4730 prot., datë 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 794/8 prot., datë 12.06.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar kërkesë për vijueshmërinë e procedurave të prokurimit.

II.33. Me shkresën nr. 5700 prot., datë 10.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1074/4 prot., datë 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar kërkesë për shprehje vendimi.

II.34. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK, se: *“Paraprakisht sqarojme se vijme ne kete ankimim, sipas konstatimeve te bera edhe me vendimin e KPP nr.498/2025 date 14.04.2025.*

*Duke qene se Komisioni i Prokurimit Publik e ka konsideruar ankesen e pare si para fillimit te afatit te ankimimit. Tashme sipas konstatimeve te KPP me vendimin e mesiperme, afati i ankimimit ka filluar me date 18.04.2025 me publikimin e njoftimit te fituesit.*

*Se pari, rivlerësimi i bere nga ana e KVO eshte ne kundërshtim me rregullat dhe ligjin e prokurimit publik. Procesi i pikezimit eshte diskrecion i vete KVO dhe nuk mund te imponohet.*

*Procesi i pikezimit, duke perjashtuar vetem piket qe merren per shkak te cmimit, eshte nje e drejte ekskluzive qe ligji i jep AK dhe Kvo perkatese. Ky proces ka te beje me perceptimin e vete anetarve te KVO duke ju referuar materialeve te dorezuara nga ana e operatoreve ekonomik. Eshte e pakonceptueshme dhe njekohesisht e paligjshme qe te imponohet mendimi i nje personi. Ne rastin*

konkret KVO e ka shprehur dhe materializuar gjykimin e tij mbi bazen e nje seri dokumentash te dorezuara nga anetaret e KVO. Nderkohe qe tashme po mbi bazen e ketyre dokumentave kerkohet qe te behet nje pikezim tjeter. Kjo gje eshte totalisht absurde, pasi KPP nuk mund te marr atributet qe ligji ja jep ne menyre diskrecionale vetem anetareve te KVO.

Se dyti, ne rivleresimin e procedures KVO dhe me heret KPP ka tejkualuar kerkesat e vete operatorit ekonomik ankimues. Konkretisht ne ankesen e tij operatori ekonomik JUBICA kerkon anullimin e procedures per shkak se nuk eshte hedhur shorti ose ne menyre alternativve rivleresimin me pikezim te operatorit Ndertuesi 2014 + Varaku E dhe ne asnje moment ripikezimin e vete operatorit ekonomik Jubica. Ne kete rivleresim qe kundershtojme, ndodh e cutditshmja, pasi tashme operatori Jubica vleresohet me 300 pike nderkohe qe me heret ishte vleresuar me 297, ne nje kohe qe nuk e ka paraqitur ne asnje moment kete pretendim.

Se treti, ajo qe eshte absurde ka te beje me konstatimet e bera nga KPP ne lidhja me disa element te pikezimit. Persa i perket kontrates se ngjashme eshte kerkuar qe operatori ekonomik Jubica te vleresohet me me shume pike, nderkohe qe ne asnje moment nuk percaktohet qe operatori Ndertuesi 2014 + Varaku ti ulen pike. Por ndodhur ne keto kushte si mund te vleresohet me me shume pike ne nje kohe qe JUBICA ne fakt eshte vleresuar me piket paksimale 20. Ne kete rast vendimi eshte totalisht i pa zbatueshem dhe jo ne perputhje me rrethanat e faktit. Ajo qe eshte absurde dhe njekohesisht favorizuese ka te beje me faktin se po te verifikohet performanca e punimeve te ngjashme, operatori ekonomik JUBICA ne kontratat e ngjashme te paraqitura nga ne menyre permanente PENALITETETE ne situacionet mujore, nga ana tjeter operatori yne nuk ka asnje penalitet.

Po ashtu sipas informacioneve publike ne akset rrugore te mirembajtura nga operatori Jubica kane ndodhur aksidente me pasoja te renda (vitin e kaluar kane vdekur 2 persona). Si ka mundesi qe ky operator ofron me shume besueshmeri per KVO dhe KPP???? Sic shikohet per kete komponent eshte bere nje verifikim i nje anshem dhe qartesisht dukshem per te favorizuar operatorin ekonomik JUBICA. Ne fakt fryma e ligjit, thekson se vleresimi me pikezim duhet te behet vetem ne referim te plotesimit te kriterave te kualifikimit. Ne rastin konkret rezulton se nga ana jone eshte plotesuar ky kriter ne masen 100 % dhe nuk ka asnje element qe te ndikoj te uljen e vleresimit ne me pak se 20 pike. Asnje motiv apo asnje arsye nuk ka as KVO dhe as KPP Qe te ule pikezimin per operatorin Ndertuesi 2014 + Varaku E.

Po ashtu edhe ne cilesine e punimeve kemi dhe propozime konkrete dhe ne asnje moment nuk rezulton qe propozimet tona te jene te pergjithshme. Ne metodologjine e punimeve eshte pershkruar ne menyre te detajuar cdo segment rrugor dhe eshte percaktuar stafi dhe mjetet qe do angazhohen. Qendrimet e KPP ne lidhje me garancine e punimeve nuk jane ne perputhje me parashikimet ligjore pasi kontrata eshte e llojit "SHERBIM" dhe nuk i nenshtrohet fare garancise, sipas rregullave te Kodit Civil. Ne asnje prej situacioneve nuk parashikohet mbajtja e nje perqindje te caktuar si garanci punimesh. Gjithashu rezulton se në datën 10.01.2025, autoriteti kontraktor, nëpërmjet KSHA ka marrë vendim për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "JUBICA" shpk dhe sipas këtij vendimi, ky komision ka bërë rivlerësim me pikë të propozimeve duke vlerësuar me më shume pikë ofertën e paraqitur nga ana jonë në raport me atë të paraqitur nga operatori ankimues "JUBICA" shpk. Ne lidhje - Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social KPP në vendim shprehet se autoriteti kontraktor duhet të kryejë një rivlerësim me më shumë

*pikë për operatorin ankimues “JUBICA” SHPK, me një diferencë të theksuar me operatorët e tjerë të kualifikuar. Nga ana juaj kërkojmë të na sqaroni se si ka arritur në përfundim KPP se operatori JUBICA duhet vlerësuar me më shumë pikë se operatorët e tjerë dhe nëse ka arritur në këtë konkluzion pse KPP në vendim nuk ka përcaktuar vetë pikët që ai duhet të mari por ja lë këtë detyrë autoritetit kontraktor? Sa është niveli i pikëve që autoriteti kontraktor duhet ti japë operatorit “JUBICA” SHPK që të plotësohet pritshmëria e KPP? Me këtë vendimarrje, KPP ka cënuar procedurën e ankimit të parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik. Në nenin 118 të Ligjit nr.162/2025 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, parashikohet:*

*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.*

*Sipas këtij neni, në rast se KPP pranon kërkesën, ai mund të urdhërojë autoritetin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim. Pra, me vendimin e tij, komisioni gjykon vendimarrjen e autoritetit kontraktor dhe merr vendimin përkatës por në asnjë rast, me vendim KPP nuk mund të urdhërojë autoritetin kontraktor që të bëjë një rivlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe pas këtij rivlerësimi të mari vendimi e urdheruar nga ana e KPP. Nëse ky institucion, në cilësinë e organit më të lartë administrativ që shqyron ankesën do të konstatonte se vlerësimi me pikë nuk ishte bërë në përrputhje me dokumentacionin e dorëzuar atëherë ai duhet ta bente vetë vlerësimin me pikë dhe më pas të urdheronte autoritetin kontraktor të bente rivlerësimin e ofertave sipas pikëve të konstatuara nga KPP. Në lidhje me propozimet për punësime lokale, sqaroj se kompania jone është shumë me lart, pasi ne i kemi të punësuar të gjithë punetoret banor të zonës. Është krejtësisht qesharake dhe aspak ligjore që të behet një vendim mbi bazën e supozimeve, nderkohe që ne kemi element konkret të provuar. Po ashtu elementi kryesor që kërkohej në këtë rrugë është mjeti borepastrues, në një kohë që ne kemi paraqitur me dokumentacion të plote 8 borepastrues, nderkohe që KPP gjykon me shumë avantazh faktin se operatori tjetër do i blejë ose do i sjellë në një moment të dytë. Si ka mundësi që KPP bindet me një fjali propozimi se do i blejë borepastrueset dhe nderkohe që ne i kemi të blera. Fryma e ligjit percakton se propozimet duhet të të bazohen mbi fazën e parë të kualifikimit, mbi atë që kemi dorëzuar në SPE dhe fizikisht pranë Autoritetit. Bindja duhet të krijohet mbi dokumentacione dhe mbi element të tjerë provues dhe jo mbi supozime. Prandaj është kërkuar që paraprakisht të kalohet faza e vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe më pas të kalohet në fazën e dytë ku trajtohen edhe ofertat dhe metodeologjitë e punimeve bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të vlerësuar në fazën e parë. Ajo që është e cuditshme në këtë*

*rivleresim te procedures nga ana e Autoritetit Kontraktor ka te beje me faktin se ne vendimarrjen e vete KPP sqaron se Autoriteti Kontraktor duhet te beje rivleresim te procedures prokurimit dhe te mireargumentoj pikezimin per cdo element te kerkuar. Ky mireargumentim duhet te behet referuar dokumentacionit te paraqitur nga operatoret ekonomik. Nderkohe AK, jo vetem qe nuk ben ndonje argumentim tjetër për procesin e pikezimit por thjeshte i vendos ato te menyre narrative, pa perdorur asnje argument se pse arriti ne keto konkluzione. Nuk eshte argumentim zbatimi i vendimit te KPP, pasi ne vetvete KPP i ka kerkuar AK qe ta mireargumentoj cdo pikezim. Sa me siper kerkojme nga ana juaj shqyrtimin e kesaj ankese dhe ne perfundim te vendosni:*

*-PRANIMIN E KERKESE SE BOE “NDERTUESI 2014” SH.P.K. & “VARAKU E” SH.P.K.*

***-RIVLERESIMIN E PROCEDURES SE PROKURIMIT PERSA I PERKET PIKEZIMIT***

*-PIKEZIMIN SIPAS VLRESIMIT TE PARE TE KVO-SE TE DATES 13.12.2024”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 25 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

**25 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1 Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**Opsioni 1) Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

|                    |                                                   |
|--------------------|---------------------------------------------------|
| V <sub>mink1</sub> | Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet          |
| P <sub>maxk1</sub> | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| O <sub>k1</sub>    | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet     |

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, Seksioni 4.4, “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

#### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

##### **A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- **Çmimi** **pikët [0 - 60]**
- **Përvoja në shërbime të ngjashme** **pikët [0 - 20]**
- **Cilësia** **pikët [0 - 15]**
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** **pikët [0 - 5]**

##### **Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomike më të favorshme bazuar në kosto**

##### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00), ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b, 3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

- 1. Çmimi** **[0 - 60 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{mink1}$  Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk1}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- 2. Përvoja në shërbime të ngjashme** **[0 - 20 pikë]**

*Operatori ekonomik duhet të përshkruajë përvojën e shërbimeve të ngjashme të realizuara në formën e CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.*

*a. Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge [0 - 5 pikë]*

*b. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0 - 15 pikë]*

### **3. Cilësia [0 - 15 pikë]**

*Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër.*

### **4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0- 5 pikë]**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.*

*Nën-kriteri:*

*a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.*

*[0 - 3 pikë]*

*b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku kryhet shërbimi si një iniciativë sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.*

*[0 - 2 pikë]*

*\*Shënim: Të gjitha dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.*

III.1.3. Në përmbushje të kritereve vlerësuese për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik ankimues “JUBICA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Oferta ekonomike dhe preventivi Loti 1;
2. Përvoja e kompanisë dhe dokumentacion provues;

**AFATI 10 vjeçar**

**OE “JUBICA” SHPK**

| Nr. | PUNË TË NGJASHME/MIRËMBAJTJE<br>RRUGORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Vlera pa TVSH |
| 3 | <p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, për operatorin ekonomik “Varaku E” SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i rrugëve në qytet, Durrës”, data e fillimit të kontratës 29.05.2023, data e mbarimit të punimeve të kontratës 18.09.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “Varaku E” SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO</p>                                                                                                                                                     | xxxxxxx |
| 4 | <p>Spërmarrje private për operatorin ekonomik “Varaku E” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i infrastrukturës publike në zonën e Zall-Herr”, data e fillimit të kontratës 19.05.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.10.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “Varaku E” SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO</p>                                                                                                                                                                                          | xxxxxxx |
| 5 | <p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK (94%) &amp; “Rajli Ndërtim” SHPK (6%) për objektin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës Adem Jashari”, data e fillimit të kontratës 18.02.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.07.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK (94%) &amp; “Rajli Ndërtim” SHPK (6%), Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO</p>                                                  | xxxxxxx |

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |         |
|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|
| 6 | Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK (97%) & “Eril B&B” SHPK (3%) për objektin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës Papa Klementi II”, data e fillimit të kontratës 25.11.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 10.03.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK (97%) & “Rajli Ndërtim” SHPK (3%), Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO | xxxxxxx |
| 7 | Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Vau Dejës, për operatorin ekonomik “Varaku E” SHPK për objektin e kontratës “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa”, data e fillimit të kontratës 25.11.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 18.01.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “Varaku E” SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO                                                                                  | xxxxxxx |
| 8 | Spërmarrje private, Kontratë Furnizimi nga operatori ekonomik “Varaku E” SHPK për objektin e kontratës “FV Asfaltobetoni në objektin në rrugët e brendshme, Bashkia Kamëz, Bathore”, për subjektin privat /porositësi“Sireta 2 F” SHPK                                                                                                                                                                                                                                                                                    | xxxxxxx |
| 9 | Spërmarrje private, Kontratë Furnizimi nga operatori ekonomik “Varaku E” SHPK për objektin e kontratës “Frezim dhe furnizim vendosje tapeti në resortin San Pietro, Gjiri Lalëzit”, për subjektin privat /porositësi “EDIL-AL-IT SHPK                                                                                                                                                                                                                                                                                     | xxxxxxx |
|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | xxxxxxx |

mirëmbajtje rrugësh

xxxxxxx

ndërtim/rikonstruksion rrugësh

xxxxxxx

4. Manuali i mbrojtjes së jetës dhe shëndetit;
5. Manuali i menaxhimit të trafikut dhe emergjencës;
6. Menaxhimi Mjedisor dhe Social;
7. Plani operacional i mirëmbajtjes;
8. Tabela e vlerësimit të riskut të punimeve të mirëmbajtjes;

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.1.7. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen

*nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.*

*Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:*

- a) bazohet mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.*
- b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;*
- c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;*
- ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.*

*III.1.8. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:*

- 1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*
- 2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*
  - 2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:*
    - a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;*
    - b) elementet fiskale;*
    - c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .*
- 3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.*
- 4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:*
  - a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose*
  - b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose*

*c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.*

*5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:*

*a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose*

*b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.*

*6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.*

*7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

III.1.9. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të koston. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të koston, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet

vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si Çmimi (0-60 pikë), Përvoja në shërbime të ngjashme (0-20 pikë), Cilësia (0-15 pikë), Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (0-5 pikë), sipas dokumenteve standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

|                                                                                               |                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| <b>Çmimi</b> <input type="checkbox"/>                                                         | <b>pikët 50</b> |
| <b>Grafiku i punimeve dhe metodologjia</b> <input type="checkbox"/>                           | <b>pikët 15</b> |
| <b>Stafi / Organizimi i Kompanisë</b> <input type="checkbox"/>                                | <b>pikët 15</b> |
| <b>Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social</b> <input type="checkbox"/> | <b>pikët 10</b> |
| <b>Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit</b> <input type="checkbox"/>      | <b>pikët 10</b> |

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të ofertës ekonomike më të favorshme, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dyplanëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues mbi kriterin e kërkuar dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët e tjerë ekonomikë, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime.

## **Kriteri:**

### **1. Çmimi [0 - 60 pikë]**

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi si dhe operatorit ekonomik të kualifikuar konkretisht “Jubica” SHPK, konstaton se në lidhje me **komponentin e parë konkretisht çmimi**, kanë paraqitur formularin e ofertës në vlerat respektive:

- "JUBICA " SHPK 239,443,000 lekë pa Tvsh
- BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk 239,442,322.5 lekë pa Tvsh



*Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:*

### **Çmimi [0-60 pikë]**

*Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.*

*Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:*

$$P_{kl} = V_{minkl} \times P_{maxkl} / O_{kl}$$

$P_{kl}$                       *Pikët e kriterit që vlerësohet*

$V_{minkl}$                 *Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet*

$P_{maxkl}$                 *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*

$O_{kl}$                       *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*

$P_{k1} = 60$  pikë për BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk

$P_{k1} = 60 \times 239,442,322.5 / 239,443,000 = 59.9998$  pikë OE "JUBICA " SHPK

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

|   | Ofertuesit                                 | Oferta ekonomike | <b>Pikët totale</b> |
|---|--------------------------------------------|------------------|---------------------|
| 1 | BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk | 239,442,322.5    | <b>60</b>           |
| 2 | OE “JUBICA” Shpk                           | 239,443,000      | <b>59.9998</b>      |

Nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, janë përcaktuar sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përlllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor për secilin ofertues. Në lidhje me komponentin “çmim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër argumentuar, rezulton se autoriteti kontraktor ka përlllogaritur drejt dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin “çmim”.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në kriterin e vlerësimit seksioni 4 i DT, autoriteti kontraktor ka sqaruar dhe ka vënë në dijeni për mënyrën e vlerësimit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar për fazën e dytë, konkretisht citoj, ***Kriteret e vlerësimit: Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00), ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b, 3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).***

Pra, për të sqaruar mbi mënyrën e vlerësimit me pikë për këtë komponent që është çmimi, autoriteti kontraktor ka sqaruar ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë fazë të dytë të procedurës së prokurimit se, vlerësimi për kriterin 1 “çmimi”, do të jetë pikët sipas formulës së deklaruar në DT dhe e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore. Duke kryer veprimet sipas formulës së dhënë në DT për këtë komponent, Komisioni sqaron se, nisur nga përlllogaritja e formës së komponentit “çmimi” kemi një diferencë prej  $(60-59.99 = 0.01 \text{ pikë})$ , referuar kriterit me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00).

### III.1.10. Përvoja në shërbime të ngjashme

[0 - 20 pikë]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë përvojën e shërbimeve të ngjashme të realizuara në formën e CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

*a. Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge [0 - 5 pikë]*

*b. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0 - 15 pikë]*

Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmime të operatorit ekonomik "JUBICA" SHPK, se disponon eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me BOE ankimues “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues mbi rivlerësimin me pikë për përvojën në shërbime të ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacioni provues nga secili ofertues "JUBICA" SHPK dhe BOE ankimues “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, në lidhje me përvojën në shërbime të ngjashme të kërkuar në dokumentet e tenderit, *Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge dhe Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh*, duke përshkruar përvojën e shërbimeve të ngjashme të realizuara në formën e CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor, konkretisht Komisioni i Vlerësimit të ofertave (KVO) mbi pretendimin për rivlerësim nga ana e BOE ankimues, për këtë kriter vlerësimi, Komisioni evidenton se, autoriteti kontraktor ka vlerësuar të dy ofertuesit në këtë fazë të dytë të procedurës objekt ankimi, me pikë maksimale të dy pjesëmarrësit duke argumentuar se: “*shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera me sukses (referuar kërkesave të DST), duke u bazuar në tipologjinë e punëve të paraqitura, performancën e punëve të kryera etj. Nga materialet e paraqitura nga të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës konstatohet që natyra e punëve të ngjashme është e njëjtë me objektin që tenderohet dhe përputhet plotësisht me kërkesat e kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Duke bërë një balancim të gjithë këtyre faktorëve që ndikojnë*

*në vlerësimin me pikë për nënkriterin "Përvoja në shërbime të ngjashme" komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerësoi që ky kriter është përmbushur plotësisht dhe të dy operatorët janë vlerësuar me pikë të barabarta. Referuar informacionit të dërguara nga autoriteti kontraktor, i cili e ka vlerësuar me 20 pikë maksimale secilin ofertues. Për të dy nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "JUBICA" SHPK dhe BOE "Ndërtues 2014" Shpk & "Varaku E" Shpk, Komisioni konstaton se, BOE "Ndërtues 2014" Shpk & "Varaku E" Shpk ka paraqitur për *përvojën e ngjashme mirëmbajtje rrugësh*, në total 6 kontrata të ngjashme në vlerën xxxxx lekë pa TVSH, të realizuara gjatë periudhës kohore të shtrirë në vitet 2020-2023, të kryera në 4 vitet e fundit. Gjithashtu, Komisioni konstaton se, referuar objektit të kontratave të realizuara, janë të ngjashme me natyrën e shërbimit të procedurës objekt prokurimi. Ndërsa, për *përvojë e ngjashme punime për ndërtim rrugësh / rikonstruksion rruge* ka paraqitur në total 13 kontrata të ngjashme në vlerën prej xxxxxxxx lekë pa TVSH, të realizuara gjatë periudhës kohore të shtrirë në vitet 2019-2023, të kryera në 5 vitet e fundit. Gjithashtu, Komisioni konstaton se referuar objektit të kontratave të realizuara, janë të ngjashme me natyrën e shërbimit të procedurës objekt prokurimi.*

Në rastin e operatorit ekonomik "JUBICA" Shpk, i cili ka paraqitur për *përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh*, në total 11 kontrata të ngjashme në vlerën xxxxxxxx lekë pa TVSH, të realizuara gjatë periudhës kohore të shtrirë në vitet 2014-2024, të kryera në 10 vitet e fundit. Gjithashtu, Komisioni konstaton se referuar objektit të kontratave të realizuara, janë të ngjashme me natyrën e shërbimit të procedurës objekt prokurimi. Ndërsa, për *përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstruksion rruge* ka paraqitur në total 14 kontrata të ngjashme në vlerën xxxxxx lekë pa TVSH, të realizuara gjatë periudhës kohore të shtrirë në vitet 2014-2023, të kryera në 9 vitet e fundit. Gjithashtu, Komisioni konstaton se referuar objektit të kontratave të realizuara, janë të ngjashme me natyrën e shërbimit të procedurës objekt prokurimi. KPP gjykon se, operatori ekonomik "JUBICA" Shpk, shfaq një eksperiencë shumë më të gjatë e më të thelluar në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit, sistemimit, si dhe të mirëmbajtjes së rrugëve e rrjedhimisht vlerësimi me 20 pikë i këtij ofertuesi është tërësisht i drejtë e i justifikuar me dokumentacionin e paraqitur nga ky i fundit. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik ofertues "JUBICA" Shpk, në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e mirëmbajtjes rutinë me performancë të rrugëve, rikonstruksionit, ndërtimit dhe sistemimit të rrugëve. Me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik "JUBICA" Shpk, dëshmon se ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlera të konsiderueshme e si rrjedhojë pretendimi i tij për një vlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me komponentin eksperiencë e ngjashme në krahasim me ofertuesin tjetër BOE ankimes, është i bazuar. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nisur nga dokumentacioni i OE "JUBICA" Shpk, ku evidentohet se plotësohen dhe tejkalohen dukshëm kërkesat e autoritetit kontraktor i cili në rastin konkret nuk ka vendosur kufizime lidhur me eksperiencën e përvojës së ngjashme, autoriteti kontraktor duhej të pasqyronte vlerësimin me pikë me një diferencë të ndjeshme për këtë operator ekonomik "JUBICA" SHPK, në lidhje me përvojën e ngjashme të shërbimeve qoftë në mirëmbajtje rrugësh ashtu edhe në ndërtim rrugësh / rikonstruksion rruge. Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Një gjykim tërësisht subjektiv dhe të paargumentuar mirë ka mbajtur autoriteti kontraktor, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në tërësi të palëve, duke argumentuar se *balancim të gjithë këtyre faktorëve që ndikojnë në vlerësimin me pikë për nënkriterin "Përvoja në shërbime të ngjashme"* komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson që ky kriter është përmbushur plotësisht dhe të dy operatorët vlerësohen me pikët maksimale, KPP gjykon se një gjykim i tillë sipërfaqësor dëshmon se autoriteti kontraktor nuk ka analizuar në thellësi përvojat profesionale (në lidhje me komponentët si koha, nr kontratash, vlerë financiare, natyrë e ngjashme), të secilit operator ekonomik pjesëmarrës në këtë fazë të dytë, të cilët rezultojnë brenda profilit të kërkuar por me eksperiencë të konsiderueshme në diferencë nga njëri-tjetrit qoftë në numër kontratash ashtu edhe në vlerë financiare, duke krijuar një bindje katërcipërisht për autoritetin kontraktor që subjekti që do të marrë përsipër të realizojë shërbimin e mirëmbajtje me performancë të rrugës për Lotin 1 objekt prokurimi. Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se, vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me përvojën e ngjashme, duke përfshirë elementë të tillë si mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge. Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i komisionit të vlerësimit të ofertave apo edhe ai i shqyrtimit të ankesave, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime me pikë të barabarta, në kushtet kur, dukshëm operatori ekonomik "JUBICA" SHPK është në avantazh të plotë pasi provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion të mjaftueshëm për t'u mos u vlerësuar me pikët maksimale me diferencë të theksuar nga ofertuesi tjetër BOE. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e shërbimeve, duhet të bëhet në përputhje edhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Për këtë argumentim, KPP ka dalë me vendim me nr. 325/2025 datë 03.03.2025, dhe autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim e secilit ofertues mbi bazën e këtyre konstatimeve. Pas rivlerësimit të kryer nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, lidhur me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me përvojën e ngjashme si mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge, për operatorin ekonomik "JUBICA" SHPK është i arsyeshëm dhe në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit, dhe për arsye ka kryer rivlerësim me më shumë pikë për operatorin ekonomik "JUBICA" SHPK, me një diferencë të theksuar parë në rrafshin krahasimor me ofertuesin tjetër BOE. KPP gjykon se operatori ekonomik "JUBICA" SHPK, shfaq një avantazh më tepër në funksion të plotësimin sa më mirë të komponentit eksperiencë e ngjashme pasi provon se ka realizuar kontrata jo vetëm të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit por edhe të njëjtë në një sasi të konsiderueshme të shtrirë në periudhë 10 vjeçare. Në këtë kuptim KPP gjykon se pikëzimi për këtë operator ekonomik "JUBICA" SHPK lidhur me këtë komponent nuk duhet të ndryshojë, ndërsa në lidhje me pikëzimin për këtë komponent vlerësimi për BOE ankimuese, KVO i ka ulur pikët dhe e ka ri-vlerësuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE.

### III.1.11. Cilësia [0 - 15 pikë]

Treguesit dhe analiza cilësore (në shërbimin e mirëmbajtje me performancë të rrugës për Lotin 1 objekt prokurimi), duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër. Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (propozimit teknik ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme, lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit, zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 15 pikë, cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Por nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik/ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në kryerjen e shërbimit duke përcaktuar elementet e saj referuar termave të referencës së cilësuar nga ana e autoritetit kontraktor por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimi të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në rastin konkret, në vlerësimin e metodologjisë së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të shërbimit (personeli kryesor, pajisjet kryesore, organizimi i stafit, siguria, siguri i cilësisë, plani i mobilizimit, garancia e punimeve dhe çdo aktivitet tjetër), zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerjes së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, organizimit, sigurimit të

cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "JUBICA" SHPK dhe BOE ankimues "Ndërtues 2014" Shpk & "Varaku E" Shpk, informacionit dhe vendimit të autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur materiale për cilësinë e propozimit teknik, ku BOE ankimues "Ndërtues 2014" Shpk & "Varaku E" Shpk ka paraqitur dokumentacionin, si vijon: Manuali i mbrotjes së jetës dhe shëndetit; Manuali i menaxhimit të trafikur dhe emergjencës; Menaxhimi Mjedisor dhe Social; Plani operacional i mirëmbajtjes dhe tabela vlerësimit të riskut të punimeve të mirëmbajtjes.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ana e BOE ankimuese, për komponentët e kriterit "cilësia" për "sigurimin e cilësisë", ka dorëzuar një *"Plan mbi sigurimin e cilësisë në mirëmbajtje"* prej 10 faqesh, ku evidentohet se, është bërë një përshkrim narrativ mbi qëllimin e tij, struktura organizimit në staf në nivel qendror dhe nivel kantieri, hapat procedural mbi auditimin e cilësisë gjatë fazës së mirëmbajtjes, korrespondenca midis palëve, një përshkrim procedural mbi hapat që do të ndiqen për mirëmbajtjen, kontrollet dhe testimet. Të gjitha pajisjet e nevojshme dhe pajisjet dhe aparatet e testimit, që i përkasin kontraktuesit ose që sigurohen nga laboratorët e jashtëm, duhet të mbahen të efektshme dhe me kalibrim të vlefshëm, sipas kodeve dhe standardeve ndërkombëtare të zbatueshme dhe të kontrolluara. Në organigramën e BOE ankimues, kemi edhe sektorin përkatës të Menaxhimit të Cilësisë lëshon Librin zyrtar të Kalibrimit që përmban listën e pajisjeve të tilla dhe certifikatave përkatëse të kalibrimit.

-Në lidhje me personelin kryesor, organizimin e stafit dhe sigurinë, BOE ankimues ka paraqitur një material prej 36 faqesh *"Manuali i mbrotjes së jetës dhe shëndetit (faza e mirëmbajtjes)"*, shoqëruar edhe në trajtë tabelare (26 faqe) dhe një material prej 35 faqesh *"Manuali i menaxhimit të trafikut dhe emergjencës"*, Politikat e Kontraktorit mbi *Mbrojtjen e Shëndetit dhe Jetes* janë zhvilluar nga departamenti i Sigurisë në përputhje me Politikat e BOE ankimues "NDËRTUESI 2014 "shpk & "VARAKU E" shpk, legjislacioneve aktuale mbi shëndetin, sigurinë dhe ambientin të Republikës së Shqipërisë dhe Standardet Ndërkombëtare. Në vijim është paraqitur organigramë e projektit me pozicionet e personelit dhe përgjegjësitë/detyrat për këtë projekt. Qëllimi i secilit prej manualeve, ku evidentohet një informacion i përgjithshëm mbi procesin e mirëmbajtjes duke përcaktuar edhe detyrat kryesore të inspektimit, politikat e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, organigrama e personelit kryesor në trajtë skematike duke cilësuar detyrat respektive sipas pozicionit të punës, sistemi i trajnimit të personelit duke përcaktuar edhe temat e trajnimit, procedurat e sigurisë dhe shëndetit në punë, udhëzime për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, procedurat e emergjencave si dhe pasqyrimi në trajtë tabelare mbi procedurën e vlerësimit të rrezikut. BOE ankimues "NDËRTUESI 2014 "shpk & "VARAKU E"shpk ka ngritur një strukturë përgjegjëse për informacionet e përgjithshme dhe trajnimin e personelit të saj dhe ato specifike të lidhura me ligjin dhe për organizimin e punimeve të mirëmbajtjes në rrugë dhe aktiviteteve, duke përfshirë certifikimin e nevojshëm kur nevojitet. Gjithashtu, BOE ankimues, në lidhje me *Menaxhimin e Trafikut* në fazën e mirëmbajtjes është e një rëndësie të veçantë, për shkak se të gjitha pothuajse aktivitetet/punimet e mirëmbajtjes do të zhvillohen në afërsi ose direkt në rrugën Bogë — Theth + K/Hani i Hotit — Vermosh + Deg.Grabom — Dogana ku shpejtësia e lëvizjes së

automjeteve dhe fluksi do të jetë mesatare. Prandaj dhe të gjithë peronat e përfshirë në këtë proces do të jene të mirë informuar dhe të kualifikuar. Për këtë arsye janë renditur edhe disa masa të përgjithshme për operimin dhe sigurinë gjatë fazës së mirëmbajtjes dhe ekzekutimit të punimeve. Për më tepër, në lidhje me situatat emergjente, BOE ankimues, ka bërë një përshkrim të detajuar në lidhje me hapat që do të ndiqen. Ku konkretisht, i gjithë stafi do të miratojë dhe ngrejë një strukturë të veçantë në rast emergjence, ku janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturës tipike që do të merret në rastet emergjente. Për këtë qëllim, BOE ankimues, ka hartuar një manual për menaxhimin e trafikut dhe emergjencave, ku në fokus është minimizimi i bllokimit të trafikut ne akset rrugore Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom — Doganë dhe Tamarë Vermosh (Doganë), për të siguruar që përdoruesit e rrugës të mos shqetësohen dhe se ky aks rrugor do të mbahet në një nivel të kënaqshëm performance ku do të garantohet një lëvizje e sigurt, e shpejtë dhe e lehtë për automjetet e emergjencave. Për të gjitha planet e menaxhimit të trafikut stafi i angazhuar në kontratën ku do të kryejë shërbimin do t'i referohet dhe konsultohet me manualin e sinjalistikës dhe skemat përkatëse dhe sipas kodit rrugor të R.SH. Gjithashtu, një person i kualifikuar për çështjet e Shëndetit & Sigurisë është parashikuar që do të emërohet për fazën e mirëmbajtjes për të garantuar që punimet do të kryhen në mënyrë korrekte për të shmangur çdo risk të mundshëm, sado i vogël që të jetë. BOE ankimues "NDËRTUESI 2014" shpk & "VARAKU E" shpk ka parashikuar t'i mundesojë forcës punëtore të gjitha informacionet dhe trajnimet e nevojshme për të kryer punën në mënyrë të sigurtë.

Në lidhje me metodat e përdorura, planin e mobilizimit, personelin kryesor dhe pajisjet kryesore, BOE ankimues, ka paraqitur një material prej 57 faqesh, *Plani Operacional i Mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë*, ku evidentohet në trajtë tabelare stafi që është i nevojshëm të angazhohet në periudhën e mirëmbajtjes së objektit, i cili është gjithëpërfshirës por jo domosdoshmërisht i nevojshëm gjatë gjithë kohës në kantier apo për proceset e punë specifike, makineritë e nevojshme që do të përdorën për kryerjen e operacioneve rutinë të mirëmbajtjes dhe të operacioneve të riparimit të segmenteve rrugorë, ku sasia dhe tipologjia e elementeve do të përzgjidhen nga personeli përgjegjës për të kryer një punë në formën me optimale dhe të sigurtë të mundshme. BOE ankimues ka dhënë një përshkrim të materialeve që nevojiten për angazhim, në periudhën e mirëmbajtjes së objektit dhe asaj operacionale të riparimit të rrugëve, ku sasia dhe tipologjia e elementeve do të përzgjidhen nga personeli përgjegjës për të kryer një punë në formën më optimale dhe të sigurtë të mundshme. Përshkrim të udhëzimeve janë parashtruar, për zgjidhjen e problemeve, të cilat kanë për qëllim të jenë një referencë e shpejtë për të ndihmuar profesionistët e mirëmbajtjes që të kuptojnë disa probleme të zakonshme në rrugë dhe t'i drejtojnë ato në seksionet përkatëse, gjatë fazës së mirëmbajtjes. BOE ankimues ka dhënë një përshkrim mbi ndjekjen e standardeve gjatë mirëmbajtjes, përshkrim mbi aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë (sipërfaqet e pjerrëta, tombinot, muret mbajtës, shtresat asfaltike, urat dhe mbikalimet, mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, list kontrolli, operacionet e dimrit). Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e BOE ankimues "Ndërtues 2014" Shpk & "Varaku E" Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e termave të referencës. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik i detajuar, mbi arsyen e vlerësimit me 15 nga 15

pikë maksimale të cilësisë/metodologjisë. Për më tepër, në bazë të informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi “Cilësinë e Propozimit Teknik” për sa i përket një elementi të shtuar në lidhje me garancinë e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me të, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material të përshkruar në këtë propozim teknik.

-Nga ana tjetër, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk, përbëhet nga:

- Plani i mobilizimit
- Organizimi i kompanisë
- Personeli kryesor
- Disponueshmëria e pajisjeve kryesore
- Sigurimi i Cilësisë
- Siguria në rrugë dhe kontrolli trafikut
- Metodologjia e punimeve të mirëmbajtjes rutinë dhe dimërore, rehabilitimi periodik, periudha e garancisë dhe punime emergjente
- Grafiku dhe programi i punimeve
- Menaxhimi ambjental

Konkretisht, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “JUBICA” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, e cila përfshin metodat e përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër. Në rastin konkret, nga ana e operatorit ekonomik “JUBICA” Shpk, në përbushje të kriterit të “Cilësisë” është paraqitur në SPE një material prej 106 faqësh “*Propozimi Teknik cilësia për punimet e mirëmbajtjes rrugore me bazë performance*”, ku evidentohet:

-një përshkrim të gjendjes aktuale të rrugëve që do të kenë mirëmbajtje rutinë dhe operatione të riparimit të segmenteve rrugore,

-Plani i mobilizimit ku përfshin një vizitë në terren dhe regjistrimi i gjithë inventari i aseteve, përpara fillimit të punimeve do vendoset tabela informuese e kompanisë me të dhënat përkatëse për këtë kontratë mirëmbajtjeje, ri-inspektimi i urave, takim me Njësitë Administrative me qëllim informimin e tyre lidhur me kontratën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe kërkesën për një bashkëpunim të frytshëm në të mirë të punës dhe qëllimit të përbashkët, Ndarja e detyrave të stafit për çdo segment, Organizimi i 3 kantierëve për vendosjen e menjëhershëm të borëpastrueseve, brenda 2 ditëve në dispozicion të objektit, si me poshtë: 1 me vendndodhje në Selcë për të mbuluar segmentin Tamarë - Vermosh 1 me vendndodhje Rrapsh, për të mbuluar segmenti K/Hani Hotit – Tamarë 1 me vendndodhje në Tamarë, për të mbuluar të dy segmentet më sipër dhe segmentin Grabom – Doganë.

-Organigrama dhe një përshkrim të personelit kryesor dhe atij të kualifikuar (manovrator, shofera, mekanik, hekurkthyes,..etj), të cilët do të jenë të angazhuar në terren për procesin e mirëmbajtjes (ku cilësohet profili, vitet e eksperiencës, si dhe fusha përkatëse e mirëmbajtjes) duke përcaktuar detyrat e secilit person të evidetuar edhe me emra të përvecëm, e kompletuar me profesionistë të



të gjitha fushave që nevojiten për një mirëfunksionim të një kompanie që punon në fushën e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe punimeve të sigurisë rrugore. Në sajë të përvojës së tyre, si dhe shumëllojshmërisë së profileve inxhinierike dhe atij të kualifikuar, kompania ofron zgjidhje teknike të gjitha situatave ndërtimore që mund të shfaqen gjatë punës së mirëmbajtjes rrugore.

-Një përshkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do të anagazhohen në mirëmbajtje rutinë edhe dimërore, dhe të operacioneve të riparimit të segmenteve rrugorë, duke patur në konsideratë shumëllojshmërinë e punimeve, edhe mjetet që kërkohen për realizimin e tyre janë të shumëllojshëm. Ofertuesi “JUBICA” SHPK nëpërmjet disponimit në pronësi edhe me qira, siguron të gjithë tipet e mjeteve që nevojiten bazuar në kërkesat në Dokumentet Standarde të Tenderit si dhe në tipologjinë e punimeve, duke siguruar një pavarësi totale për shërbim të plotë dhe cilësorë, dhe angazhim të menjëhershëm me lidhjen e kontratës.

-Një përshkrim të planit për sigurimin e cilësisë, ofertuesi “JUBICA” SHPK ka të ngritur strukturën e nevojshme për të garantuar Sigurimin e Cilësisë dhe Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Në mënyrë që të garantohet cilësia e punimeve është e domosdoshme që të shmanget periudha e ngricave për fillimin e punimeve. Nëpërmjet stafit të trajnuar dhe me eksperiencë, si dhe të certifikuar sipas certifikatave të mesiperme, shoqëria “JUBICA” sh.p.k. garanton plotësimin e këtyre kriterëve të domosdoshme gjatë gjithë proceseve të punës. Praktika që shoqëria ndjek për të arritur standardet maksimale në këto fusha janë duke përcaktuar trajnimet e vazhdueshme të stafit, monitorimi dhe raportimi i gjithë stafit, praktikat me karakter parandalues nëpërmjet planifikimit paraprak në mënyrë që t’i paraprihet cënimit cilësisë dhe sigurisë në punë. Duke qenë se punimet për mirëmbajtjen rrugore përfshijnë tre kategori kryesore, Mirëmbajtje Rutine, Punime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Dimërore, atëherë dhe plani për sigurimin e cilësisë është fokusuar në këto tre kategori. Gjithashtu, duke qenë se shoqëria “JUBICA” SHPK ofron një garanci punimesh 4-vjeçare për punimet e këtij objekti, atëherë sigurimi i cilësisë merr një rëndësi të veçantë për punimet rehabilituese. Si edhe Monitorim i vazhdueshëm për defekte të mundshme në mënyrë që të riparohen sa më shpejtë.

- Për shkak të natyrës së shërbimeve, stafi që do kryej punimet, me rastet, të jetë i ekspozuar ndaj situatave shqetësuese të cilat mund të përfshijnë rrezikun e shkallëve të ndryshme, tek stafi kontraktues dhe/ose publiku. Duke qenë se burimet njerëzore janë aset me vlerë, atëherë shëndeti dhe siguria në punë merr një rëndësi të veçantë gjatë punës së shoqërisë tonë. Për këtë arsye është hartuar një Plan i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë, i cili përmban instruktimin teknik të stafit të shoqërisë në varësi të llojit të punës dhe sidomos instruktimin për punimet në rrugë, kontrolli dhe menaxhimi i trafikut rrugor si dhe montimi i sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale) ku përfshin masat për kontrollin e duhur të trafikut siç nevojitet apo kërkohet nga Mbikqyrësi, ka parashikuar të vendosë persona me flamur ose semafor lëvizës, detyra e të cilëve do të jetë të drejtojnë lëvizjen e trafikut përmes ose anash punimeve. Me qëllim minimizimin e ndërprerjes së trafikut, nga stafi shoqërisë parashikohet të mbyllet me gardh përkohësisht pjesa e sheshit të ndërtimit, siç nevojitet për të siguruar një barrierë vizive midis zonës së punimeve dhe trafikut të afërt.

-Në lidhje me metodat e përdorura është përcaktuar edhe metodologjia e punime të mirëmbajtjes ku përfshihen masat konkrete mbi mirëmbajtjen rrugore dimërore, mbi mirëmbajtjen rrugore rutinë, përshkrim të punimeve të rehabilitimit + periodike të detajuara sipas detyrave respektive, ku

përfshin: Pastrimi i kanaleve dhe kunetave, Mbushja dhe nivelimi i bankinave, Pastrimi i vegjetacionit, Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera, Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale, pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike) dhe ndriçimit, masat konkrete për Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit, masat konkrete për Punimet e mirëmbajtjes Dimërore, ku përfshihet edhe Organizimi i kantierëve për mirëmbajtjen dimërore, për të cilat shoqëria JUBICA sh.p.k. dhe të ketë në dispozicion 3 kantiere ku do të vendosen mjetet e nevojshme për këto punime, si dhe një përshkrim të materialet kundër ngricës që do të përdoren. Fillimisht, nëpërmjet mjeteve borëpastruese që shoqëria jonë ka në dispozicion është shmangur tërësisht shpërndarja e kripës me krahë. Gjithashtu është parashikuar të vendosen tabela sinjalizuese për dëboren dhe ngricat që mund të krijohen në rrugë. Vendosja e këtyre tabelave do të bëhet bazuar në përvojën e stafit të shoqërisë si dhe njihjen që do të ketë stafi për segmentin rrugor nën shërbim. Tabelat sinjalizuese do japin informacion për zonat në të cilat ka ngrica dhe për përdorimin ose jo të zinxhirëve. Përveç kësaj, do të pajiset stafi i shoqërisë me rroba të dukshme, ndërsa e mjetet që do të përdoren do të jenë të pajisura me ndriçimin special për këto tipe punimesh, këto pasi shërbimi i mirëmbajtjes dimërore do të kryhet edhe gjatë natës. Në drejtim të menaxhimit të gjithë situatës në kantiere dhe në terren, ofertuesi “JUBICA” SHPK do të ofrojë një personel në shërbim 24 orë, i cili do të shërbejë edhe si kontakt kryesor për raportimin e gjendjes në rrugë. Këto raportime do t’i bëhen mbikqyrësit dhe autoritetit kontraktor dhe do të kryhen në mënyrë telefonike në intervale të caktuara kohore, në mënyrë që të jepet një informacion real për kalueshmërinë e rrugës. Gjithashtu do të bashkpunojmë ngusht me Policinë Rrugore si dhe me strukturat Lokale nëpër zonat ku kalon rruga.

-grafiku i punimeve 48 mujor si dhe periudha e garancisë prej 4 vitesh, Ofertuesi ka bërë një përshkrim të punimeve rutinë, të cilat janë punime që vijnë pa ndërprerje nga fillimi në fund të kontratës, ku përfshihet edhe mirëmbajtja dimërore. Punimet e rehabilitimit janë parashikuar të realizohen në vitin e parë të marrvëshjes kuadër dhe do të arrijnë deri në masën 80 % e totalit të punimeve të parashikuara për rehabilitim, pasi 20% do të lihet punimeve periodike përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Çdo projekt i punimeve të rehabilitimit do të jetë i kontrolluar dhe i sigluar nga një auditues i certifikuar i sigurisë rrugore. Grafiku jep informacion në lidhje me punët që do kryhen si dhe kohën kur do fillojë e përfundojë punimi rehabilitues. Për përpilimin e grafikut të punimeve, stafi teknik i shoqërisë ka marrë në konsideratë kushtet e rrugës, të metat që ajo paraqet, ndikimin që këto të meta kanë në gjendjen e rrugës dhe se si ndikojnë ato drejtuesi i mjetit, nevojën emergjente që kanë këto të meta për t’u riparuar si dhe kushtet klimaterike që priten në vazhdim të zbatimit të kontratës.

-një përshkrim të listuar të dokumentacionit i cili do të dorëzohet në fund të punimeve të rehabilitimit/periodike,

-dhe punimet e emergjencës, janë punime që nuk mund të përcaktohen fillimisht por që mund të ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kontratës si fenomene të paparashikueshme stuhi shiu me kohezgjatje e sasi të madhe, termete, rrëshqitje, cedime e tj. Përse i perkete punimeve emergjente, nga ana e stafit teknik janë në vëmendje fenomenet natyrore që mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe si rrjedhojë punime emergjente për riparimin e këtyre dëmeve.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë (në rastet kur nuk aplikohet përlllogaritje me formulë) megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me vlerësimin e pikëve për këtë kriter, nga shqyrtimi i proces-verbalit të argumentimit të vlerësimit të bërë nga autoriteti kontraktor, si edhe analizuar në rrafshin krahasimor të dy propozimeve teknike për cilësinë, e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar në fazën e dytë, si edhe të pretendimeve të BOE ankimues rezulton se, ku i fundit pretendon pikët maksimale, në lidhje me kriterin e faktorit “cilësia”. Në fazën e dytë të vlerësimit Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar me pikët maksimale nga 15 pikë secilin pjesëmarrës. Ndërsa, autoriteti kontraktor ka vlerësuar me 15 pikë BOE ankimues “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk dhe me 14 pikë operatorin ekonomik “JUBICA” Shpk, duke argumentur këtë diferencë me faktin se, personeli kryesor i paraqitur në formularin e vetdeklarimit të operatorit ekonomik “Jubica” shpk., si staf i disponueshëm për zbatimin e kësaj kontrate ka me pak eksperience në vite pune (duke ju referuar viteve të diplomimit të secilit inxhinier) në krahasim me bashkimin e operatorëve ankimues “Ndërtuesi 2014 shpk & Varaku E shpk” i cili referuar formularit të vetdeklarimit ka vënë në dispozicion me shumë staf të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe me më shumë eksperiencë në vite pune. Gjithashtu nga operatori ekonomik “Jubica” shpk, nuk janë paraqitur CV- të e personelit kryesor në mënyrë që të gjykohet më drejtë mbi certifikatat e trajnimeve, kualifikime pasuniversitare të ndryshme, eksperiencat e mëparshme ndër vite etj. Në total duke ju referuar materialit të paraqitur për këtë kriter Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar me 15 pikë bashkimin e operatoreve ankimues “Ndërtuesi 2014 shpk & Varaku E shpk” dhe me 14 pikë operatorin ekonomik “Jubica” shpk.

Ndërkohë, referuar informacionit të dërguara nga autoriteti kontraktor, i cili është shprehur se, ka një diferencë midis ofertuesëve në këtë fazë, e shprehur kjo me vlerësimin me pikë si më lart cituar, ku autoriteti kontraktor ka argumentuar se, *personeli kryesor i paraqitur në formularin e vetdeklarimit të operatorit ekonomik “Jubica” shpk., si staf i disponueshëm për zbatimin e kësaj kontrate ka më pak eksperiencë në vite pune (duke ju referuar viteve të diplomimit të secilit inxhinier) në krahasim me BOE “Ndërtuesi 2014 shpk & Varaku E shpk” i cili referuar formularit të vetdeklarimit ka vënë në dispozicion me shumë staf të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe me më shumë eksperiencë në vite pune. Gjithashtu, nga operatori ekonomik “Jubica” shpk, nuk janë paraqitur CV- të e personelit kryesor në mënyrë që të gjykohet më drejtë mbi certifikatat e trajnimeve, kualifikime pasuniversitare të ndryshme, eksperiencat e mëparshme ndër vite etj.*

Në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e BOE ankimese “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, është paraqitur një metodologji e përgjithshme në përmbushje të elementëve të propozimit teknik të kërkuar nga autoritetit kontraktor në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” shpk i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës ku evidentohet elementi plani i mobilizimit të 3 kantierëve si edhe garancia e punimeve për 4 vite. Ndërsa në lidhje me personelin kryesor, konkretisht stafin inxhinierik, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, Komisioni konstaton se, BOE ankimese “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, ka vënë në dispozicion të procedurës që do të prokurohet, një numër më të lartë në staf si dhe në vite eksperiencë pune, në krahasim me stafin e personelit kryesor të operatorit ekonomik “JUBICA” shpk. Gjithashtu, rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “JUBICA” shpk janë përshkruar një listë e dokumentacionit, i cili do të dorëzohet në fund të punimeve të rehabilitimit/periodike, përshkrim i grafikut të punimeve 48 mujor si dhe periudha e garancisë prej 4 vitesh, ku janë kushte favorizuese, të cilat ndjeshëm kanë sjellë vlerësimin e ofertës së tij, për këtë kriter me një diferencë pikësh midis ofertuesëve. Për këtë kriter, autoriteti kontraktor ka marrë masa për ripërlllogaritjen e pikëve si dhe rivlerësimin e pikëve për secilin ofertues pjesëmarrës të kualifikuar, në sistemin e prokurimeve elektronike, në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, për secilin ofertues. Për më tepër, KPP ka dalë me vendimin me nr. KPP 325/2025 datë 03.03.2025, ku edhe autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim e secilit ofertues mbi bazën e këtyre konstatimeve.

### **III.1.12. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-5 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0 - 3 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0 - 2 pikë]

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues dhe si edhe vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar secilin ofertues, në rastin konkret BOE ankimese “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, një material prej 19 faqesh, ku kemi një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor mjedisor shqiptar si dhe qëllimi i planit të menaxhimit mjedisor, një përshkrim të procedurave të zbatuara nga kompania për zbutjen e efekteve negative, procedurat e monitorimit, auditim i zbatueshmërisë së sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social, një përshkrim checklist mbi procedurat e menaxhimit

të çështjeve sociale i cili përfshin konsultimi dhe informimi i publikut, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, angazhimi i palëve të interesit, takimet publike dhe procedura e menaxhimit të ankesave. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura. Në raport vihet re një përshkrim i masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit, plani i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Referuar informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social për sa i përket Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike, Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike dhe Propozime konkrete për përmirësimet të ekonomisë lokale të zonës ku do të kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material nga ana e BOE.

Ndërsa, operatorit ekonomik "JUBICA" SHPK ka dorëzuar një material prej 33 faqësh "*Propozimi për Uljen e Ndikimit në Mjedis dhe ndikimi social*", ku kemi një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor mjedisor shqiptar si dhe qëllimi i planit të menaxhimit mjedisor, një përshkrim të projektit (ku evidentohet vendndodhja, klima, bimësia, mjedisi), një përshkrim të planit konkret mbi monitorimin mjedisor dhe social (PMMS) ku evidentohen edhe masat lehtësuese, një përshkrim të përdorimit të materialeve ekologjike dhe i pajisjeve/makinerive të transportit, ekologjike ku evidentohet që do të jenë pajisje me moshë të re, të avancuara për sa i përket teknologjisë së djegies së karburantit, si dhe në përputhje me legjislacionin Evropian dhe atë Kombëtar për sa i përket gazrave që çlirohen nga përdorimi i tyre. Moshë e re mjeteve dhe teknologjia e avancuar garanton djegien e plotë të karburantit pa lënë gazra të dëmshëm që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit përreth. Për këtë arsye kompania parashikon ndërrimin dhe blerjen e dy mjeteve borëpastruese të reja brenda afatit 2 vjeçar. Një trajtim inovativ që do të përdorë shoqëria "JUBICA" SHPK në lidhje me makineritë ekologjike është përdorimi i pajisjeve për prerjen e bimësisë dhe shkurreve që rriten dhe kanë një dendësi të madhe në këtë zonë të bukur të Alpeve Shqiptare, në përdorim prerës që janë me bateri të rikarikueshme, pra me ndotje zero dhe jo lëndë djegëse naftë/benzinë. Një përshkrim të ndikimeve të parashikuara mjedisore (tokë, ajër, ujë, zhurmë, mbetje inerte), të projektit dhe gjithashtu ka ofruar masa të përgjithshme zbutëse për të minimizuar nëse jo eliminuar ndikimet potencialisht negative, në mënyrë që të sigurohet që ndërhyrjet sipas projektit të propozuar të mos shkaktojnë ndikime mjedisore përtej nivelit të pranueshëm. Një përshkrim të propozojmë për marrjen e disa masave për përmirësimin e impaktit social: bashkëpunimin me zyrën rajonale të punës dhe njësinë e qeverisjes vendore për identifikimin e krahut të përshtatshëm të punës në zonë. Për këtë, shoqëria JUBICA së fundmi është bërë pjesë e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe ka firmosur Marrëveshje për të dhënë kontributin e saj në lidhje me "Programin e nxitjes së punësimit" duke hapur vende të lira pune dhe duke u dhënë mundësinë kandidatëve të zonës për t'u punësuar; Njoftim në mediat dhe gazetatat lokale dhe portalet sociale për pozicionet vakante të punës; Punësim të banorëve në afërsi të projektit duke i dhënë prioritet punësimit në pozicione specifike pune ku mund të punësohen anëtarët e familjeve në nevojë dhe gjinia femërore; Prioritet përdorimi i produkteve të zonës për ushqimin të stafit duke rritur të ardhurat e bizneseve në afërsi të projektit. Një përshkrim të planit të menaxhimit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme. Inovatore është edhe procedura e menaxhimit të

mbetjeve përmban gjithashtu një gjurmues të mbetjeve në format elektronik i cili do të përditësohet periodikisht sipas punimeve të ndërmarra dhe mbetjeve të krijuara. Gjithashtu, operatori ekonomik “JUBICA” Shpk ka dorëzuar një kontratë me Landfillin e Bushatit për mbeturinat e grumbulluara/materialet e konsumuara, kontrata me Pikën e Inerteve dhe Depozitimin e tyre në Gajtan si edhe kontrata me Servisin për Depozitimin e Vajrat, lubrifikantët. Në lidhje me këtë kriter kemi në fillim I-nënkriterin Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efëcente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore të përcaktuar në dokumentet e tenderit me 0-3 pikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Jubica” SHPK janë përcaktuar dhe përshkruar masat që do të ndërmarrë gjatë zbatimit të projektit për minimizimin e ndikimeve në mjedis si dhe është specifikuar materialet dhe lënda e parë të cilat do të blihen të cilësisë më të lartë dhe ekologjike me mjedisin. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimes “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, është paraqitur hyrja, qëllimi i projektit, si dhe një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor. Në këtë raport, vihet re një përshkrim i përgjithshëm i projektit kryesisht për hapat që ndiqen gjatë mirëmbajtjes së rrugëve, si dhe përshkrim i përgjithshëm i komponentëve të mjedisit si flora, fauna, ajër, ujë dhe klima, ndikimi i aktivitetit të zhvillimit të projektit në komponentët mjedisorë si dhe masat rehabilituese. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura. Në lidhje me këtë kriter kemi në fillim II-nënkriterin Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve të përcaktuara në dokumentet e tenderit me 0-2 pikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesit e kualifikuar, si dhe nga argumentimi i dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “JUBICA” Shpk ka paraqitur propozime konkrete të tilla si punësime të banorëve të zonës përreth ku do të zhvillohet projekti, si dhe të atyre që janë forcë punëtore të pakualifikuar për procese pune të thjeshta, trajnim i stafit apo teknikë të punësuar të zonës që të mësojnë proceset e punës, duke i kualifikuar ata. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka gjykuar, që të dy ofertuesit e kualifikuar të vlerësohen për këtë kriter me nga 4 pikë respektivisht secili. Për të dy nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "JUBICA" SHPK dhe BOE ankimes “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, vlerësimit të kryer nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë paraqitur materiale për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis. Ata në materialet e tyre respektivë, kanë përcaktuar dhe përshkruar masa të përgjithshme që do të ndërmarrin gjatë kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes rutinë/dimërore, operacioneve të ristrukturimit të rrugëve si dhe për minimizimin e ndikimit në mjedis në zonën ku do të zhvillohet objekti. Gjithashtu, kanë hartuar masa për menaxhimin mjedisor, masa për menaxhimin e mbetjeve, hapat e procesit të monitorimit, etj. Ndërsa, nga secili ofertues janë paraqitur propozime për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës gjatë kryerjes së shërbimit. Një vlerë e shtuar, për ofertuesin "JUBICA" SHPK, inovatore është edhe procedura e menaxhimit të mbetjeve përmban gjithashtu një gjurmues të mbetjeve në format elektronik i cili do të përditësohet periodikisht sipas punimeve të ndërmarra dhe mbetjeve të krijuara, si dhe kontrata e lidhura me landfillet përkatëse

të llojit të mbetjeve. Bazuar në këto propozime të dy operatorët janë vlerësuar secili me nga 4 pikë, për të dy nënkritere së bashku. Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit mjedisor dhe social, autoriteti kontraktor ka marrë masa për ripërlllogaritjen e pikëve si dhe rivlerësimin e pikëve për secilin ofertues pjesëmarrës të kualifikuar, në sistemin e prokurimeve elektronike, në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, për secilin ofertues. Për më tepër, KPP ka dalë me vendim me nr. KPP 325/2025 datë 03.03.2025, ku edhe autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim e secilit ofertues mbi bazën e këtyre konstatimeve. Procesi i pikëzimit në procedurat e shërbimeve me performancë, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart, pretendimet e BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

